

Rregullimi i Procedurës dhe të Dhënat Disiplinore në Kryeqytet 2022-2023

Hyrje

Ndërtimi i një administrate lokale transparente dhe llogaridhënëse dhe me integritet është njëri nga synimet kryesore të Republikës së Kosovës. Megjithatë, në veçanti integriteti në shërbimin publik vazhdon të mbetet sfida. Në nivel komunal evidentohet nevoja për të promovuar hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit në shërbimin publik si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës.¹

Për ta arritur këtë qëllim, përpos llogaridhënies para publikut, institucionet e Kosovës kanë ndërtuar mekanizma konkret të cilët kërkojnë llogari nga nëpunësit në procedurat administrative, duke mos përjashtuar edhe procedurën penale në rastet kur shkeljet sanksionohen me Kodin Penal.

Mekanizma të llogaridhënies për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës janë vlerësimi i performancës dhe në veçanti procedurat disiplinore. Për këtë qëllim komunat kanë hartuar kodet e etikës ndërsa Qeveria e Kosovës ka miratuar rregulloren përkatëse për disiplinë.

BIRN në hulumtimet paraprake kishte konstatuar se një numër i vogël i zyrtarëve të nivelit lokal përfshihen në procedura disiplinore për shkeljet e kryera gjatë punës.

Me qëllim të dokumentimit të kuptimit të arsyeve pse në vend ka numër të vogël të procedurave disiplinore, BIRN ka realizuar pesë hulumtime në komuna të ndryshme të vendit për të matur nivelin e edukimit për disiplinën dhe nivelin e zbatimit të procedurave dhe kodit të etikës në komunat përkatëse.

Në Kryeqytet BIRN ka gjetur se:

- Kryeqyteti ende nuk e ka miratuar Kodin e Etikës për zyrtarët e saj;
- Draft-Kodi i Etikës e parasheh rregullimin e disiplinës për të emëruarit politikë;
- Draft-Kodi i Etikës së Kryeqytetit përmban kufizime për lirinë politike të të emëruarve politikë;
- Kryeqyteti nuk parasheh kritere për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit për të emëruarit politikë si dhe procedurë të qartë disiplinore ndaj tyre;
- BIRN ka identifikuar probleme të theksuara në identifikimin e saktë të konceptit të nepotizmit dhe disa fusha të caktuara nga Rregullorja për Disiplinë nga zyrtarët komunalë;

¹ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2023, i qasshëm në linkun - https://integrimievropian.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf

- Kryeqyteti nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë/aktivitet për të informuar qytetarët e saj për të drejtën e tyre për të iniciuar ankesë ndaj zyrtarit komunal kur ka pretendime për shkelje disiplinore;
- Të gjitha procedurat disiplinore janë hapur sipas detyrës zyrtare nga mbikëqyrësit direkt kurse nuk ka procedura të cilat janë iniciuar nga qytetarët, zyrtarët komunalë apo organizatat e shoqërisë civile;
- Kryeqyteti nuk ka të përcaktuar rregulla specifike për kompensimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore brenda komunës;
- BIRN ka identifikuar mungesë të trajnimeve për anëtarët e Komisionit Disiplinor;
- BIRN ka identifikuar mungesë të një mekanizmi mbikëqyrës ndaj cilësisë së punës së Komisionit Disiplinor, në veçanti politikën ndëshkimore disiplinore të komisioneve disiplinore.

Metodologjia

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara në mes muajve shkurt dhe mars, duke përdorur tri forma të grumbullimit të të dhënave.

BIRN në metodologji ka përcaktuar qëllimet e hulumtimit duke i grupuar ato në tri shtylla:

- Niveli i Edukimit mbi Etikën dhe Disiplinën
- Analizimin e bazës ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës
- Zbatimin në praktikë të kodeve të etikës dhe rregullave disiplinore

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë grumbulluar të shtrira në tri faza hulumtuese.

Në fazën e parë, BIRN ka realizuar një takim informues me zyrtarë të Kryeqytetit dhe gjatë takimit janë marrë të dhëna paraprake për përgatitjen e fazës së dytë. Në fazën e parë BIRN po ashtu ka analizuar bazën ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës në Kryeqytet në raport me kërkesat që përcaktohen në standardet europiane të qeverisjes së mirë lokale.

Të dhënat nga faza e parë janë përdorur për të zhvilluar gjetjet e këtij raporti por edhe për të hartuar një pyetësor me 14 pyetje hulumtuese për zyrtarët të cilët janë përfshirë në studim.

Faza e dytë ka korresponduar me një matje në terren për të testuar njohuritë e zyrtarëve komunalë lidhur me procedurën disiplinore.

10 zyrtarë komunalë të përzgjedhur nga Kryeqyteti i janë nënshtruar një procesi të testimit me 14 pyetje të përgatitura nga BIRN, e të cilat përmbajnë informacione për procedurat disiplinore.

Testimi është realizuar në prani të hulumtuesve të BIRN dhe zyrtarëve të Kryeqytetit.

Zyrtarët e përfshirë në këtë studim ishin nga drejtoritë e Prokurimit, Financave, Administratës, Arsimit, Shëndetësisë. Identiteti i tyre është mbajtur i fshehur për qëllime të mbrojtjes së privatësisë.

Në fazën e tretë të hulumtimit, BIRN ka pranuar nga Kryeqyteti përgjigjet në 12 pyetje hulumtuese nga të cilat janë mbledhur të dhëna për:

- Numrin e ankesave disiplinore;
- Numrin e ankesave ex-officio disiplinore;
- Numrin e vërejtjeve nga menaxherët e linjës;
- Numrin e vërejtjeve dhe sanksioneve disiplinore nga komisionet përkatëse;
- Numrin e ankesave të hedhura poshtë nga institucionet, si Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil;

Për këtë fushë dhe ka realizuar një intervistë të thellë me U. D Udhëheqësin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, e cila korrespondon me mbi 30 pyetje hulumtuese. Të dhënat nga statistikat dhe intervista e thellë do të paraqiten në vazhdimësi gjatë këtij raporti.

Gjetjet kryesore

Kryeqyteti ende nuk e ka miratuar Kodin e Etikës për zyrtarët e saj

Në periudhën hulumtuese të këtij projekti, Kryeqyteti ka qenë në proces të hartimit të Kodit të Etikës, kurse të dhënat e gjetura lidhur me Kodin (në vazhdim Draft-Kodi) do t'i referohen Draft-Kodit të dërguar BIRN-it nga Sektori i Kryeqytetit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Europian më datë 20.03.2024.

Procedura disiplinore dhe sjelljet e zyrtarëve përveç Rregullores për Disiplinë janë rregulluar me disa rregulla të pashkruara lidhur me obligimet që ata kanë gjatë orarit të punës, sipas U.D Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Kryeqytet, z. Fadil Aliu.

“Vetëm rregullorja është, dhe disa rregulla të pashkruara; mirësjellja, orari, qytetarin me prit me kujdes, me respekt”.²

Draft-Kodi parasheh që kompetent për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit do të jetë Njësia e Burimeve Njerëzore, si dhe kjo njësi do ta ketë përgjegjësinë e dhënies së interpretimeve dhe sqarimeve lidhur me Kodin kur është e nevojshme³.

Megjithatë, kjo Njësi nuk ka qenë e përfshirë në procesin e hartimit të Kodit të Etikës dhe nuk ka qenë pjesë e grupit punues, ka njoftuar z.Aliu.

“Nuk kam qenë pjesë e ekipit punues për çudi. Është marrë sektori për integritet, E kanë angazhuar dikush prej kabinetit, ka qene befas. Burimet njerëzore nuk kanë qenë të përfshira. Asnjë zyrtar nga Burimet Njerëzore”.

Tutje, pas miratimit të Kodit, Njësia e Burimeve Njerëzore do të jetë përgjegjëse për informimin e zyrtarëve të Kryeqytetit për kodin, detyrimet dhe deklaratat e ndërlidhura në momentin e fillimit të punësimit ose mandatit të tij/saj.⁴

² Intervistë e realizuar nga BIRN me z.Fadil Aliu, .U.D Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Kryeqytet, më datë 18.03.2024

³ Draft Kodi i Etikës së Kryeqytetit, neni 30 par.3, i dërguar më 20.03.2024

⁴ Draft Kodi i Etikës së Kryeqytetit, neni 29 par.1, i dërguar më 20.03.2024

Draft-Kodi i Etikës së Kryeqytetit përmban kufizime për lirinë politike të të emëruarve politikë

Draft-Kodi i Etikës i Kryeqytetit në nenin 5 *“Respektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve”*, ka paraparë kushtëzime të cilat nuk kanë asnjë mbështetje ligjore dhe për më tepër kufizojnë të drejtat dhe liritë politike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet relevante për zgjedhjet dhe qeverisjen lokale, nuk kanë përcaktuar ndonjë kufizim për ndërrimin e subjektit politik i takojnë.

“Zyrtari politik duhet të respektojë vullnetin e votuesve të partisë deri në fund të mandatit duke zbatuar programin politik të partisë në emër të së cilës ka marrë mandatin, si dhe të shmangë ndërrimin e partisë gjatë ushtrimit të mandatit”, përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 5 në Draft-Kodin e Etikës.

Ky përcaktim i dedikohet ekskluzivisht zyrtarëve komunalë politikë dhe urdhëron *“duhet”*, të respektohet vullneti i votuesve deri në fund të mandatit.

Gjithashtu, duke qenë se sistemi zgjedhor që përdor lista të hapura dhe një zonë të vetme zgjedhore nuk kufizon ndryshimin e partive politike të anëtarëve të Kuvendit Komunal dhe duke pasur parasysh se mandati i këshilltarit komunal i përket atij individ, përbën shkelje ligjore ndalimi i lëvizjes brenda grupet e përfaqësuar në Kuvendin Komunal nëpërmjet Kodit të Etikës.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nuk i njeh partitë politike (grupet politike) si subjekte të veçanta politike, por mandatin e një anëtari të Kuvendit Komunal e konsideron si subjekt të veçantë përfaqësues.

Përderisa Komunitat kanë të drejtën e plotë që të përcaktojnë sjelljet që duhet të shmangen dhe sjelljet që priten nga zyrtarët, në asnjë rrethanë nuk mund të vendosin kufizime që cenojnë lirinë e përcaktimit politik të zyrtarëve politikë.

Kryeqyteti në Draft-Kodin e tij ka paraparë një komision të veçantë dhe masa disiplinore për të emëruarit politikë

Rregullorja për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë 11/2020 dhe Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civilë 01/2024 që ka shfuqizuar rregulloren paraprake, e që derivon nga Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197, përjashton të zgjedhurit, të emëruarit politikë dhe zyrtarët e kabinetit.

Megjithatë, Kryeqyteti në Draft-Kodin e saj ka paraparë formimin e një Komisioni të veçantë të cilin e krijon Kuvendi Komunal, i cili monitoron zbatimin e Kodit e i cili në përbërjen e tij ka 5

anëtarë, 2 prej të cilëve janë nga anëtarët e Kuvendit të komunës, 2 nëpunës civilë dhe 1 qytetar me integritet dhe i njohur publikisht për komunën.⁵

Megjithatë, në Draft-Kodin në fjalë nuk është i paraparë asnjë kriter lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit komunal ose anëtarëve tjerë pjesë të Komisionit, i cili do të mbikëqyrë dhe shqiptojë masa disiplinore ndaj të emëruarve politikë.

Kryeqyteti në Draft-Kodin e saj ka paraparë masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen nga Komisioni i Kuvendit Komunal i quajtur “Komisioni i Etikës” ndaj të emëruarve politikë të cilët kryejnë shkelje nga Kodi i Etikës.

Aty parashihet edhe qëllimin e masës, ku parashihet “*dënimi në mënyrë publike*” sjellja e papranueshme dhe ndikimi moral në sjelljen e ardhshme të përfaqësuesit të zgjedhur.

Masat të cilat mund të shqiptohen ndaj të emëruarve politikë në bazë të këtij Draft-Kodi përveç ndalimit të pagës deri në 15% për tre muaj, është edhe vërejtja publike e cila shqiptohet në mbledhje të kuvendit - publikimi i vërejtjes në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Neni 33 par. 5 - “Masat për shkelje të Kodit të Etikës janë: Vërejtja publike - e cila shqiptohet në mbledhje të kuvendit dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës; Dënimi me ndalje deri në 15% të pagës për tre muaj”.

Në anën tjetër, për nëpunësit civilë Rregullorja tashmë e shfuqizuar 11/2020 dhe ajo aktuale 01/2024 për disiplinën e nëpunësve civilë përcaktojnë që seancat e Komisionit Disiplinor janë të mbyllura dhe mbahen në prani të anëtarëve të Komisionit si dhe parasheh numër më të gjerë të masave disiplinore për shkelje disiplinore.

Më tutje, Draft-Kodi i Etikës nuk ka paraparë se për cilat shkelje mund të shqiptohen masat në fjalë.

*“Të zgjedhurit dhe të emëruarit politikë do t’i nënshtrohen procedurës disiplinore të vendosur nga ky Kod në rast të shkeljes së ndonjë prej dispozitave të Kodit. Qëllimi i masës është që të dënohet publikisht sjellja e papranueshme në kundërshtim me këtë Kod dhe të ketë një ndikim moral në sjelljen e ardhshme të përfaqësuesit të zgjedhur”.*⁶

Ndonëse Draft-Kodi parasheh që të emëruarit politikë do t’i nënshtrohen procedurës disiplinore të vendosur nga i njëjti Kod, nuk është e qartë se për cilën procedurë është fjala. Neni 33, paragrafi 5 nuk e përcakton qartë se kur është i zbatueshëm rregulli i përcaktuar në nënparagrafin 5.1 dhe kur duhet të zbatohet rregulli në nënparagrafin 5.2. Kompetenca për të vendosur në këtë kontekst është lënë në diskrecionin e komisionit.

⁵ Draft Kodi i Etikës së Kryeqytetit, neni 33 par.8, i dërguar më 20.03.2024

⁶ Draft Kodi i Etikës së Kryeqytetit, neni 33 par.4, i dërguar më 20.03.2024

Gjithashtu, paragrafi 7 i nenit 33 nuk e specifikon formatin e raportimit dhe as nuk e përcakton periudhën e raportimit. Ai nuk përcakton se sa shpesh gjatë gjithë vitit, i raporton Kuvendit për nivelin e zbatimit të Kodit.

Neni 33, paragrafi 7, mund të bie ndesh me nenin 30, paragrafi 3, “Njësia e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit si dhe zhvillimin e trajnimeve për zyrtarët e Kryeqytetit”.

Nëse Komisioni i Kodit të Etikës i raporton kuvendit, atëherë përgjegjësia e mbikëqyrjes duhet të hiqet nga juridiksioni i Njesisë së Burimeve Njerëzore sepse dy institucione nuk mund të shërbejnë njëkohësisht në mbikëqyrjen e një dokumenti/politike të vetme.

Në nenin 32 të Draft-Kodit parashihet që procedura disiplinore për zyrtarët publikë zhvillohet sipas ligjit për zyrtarët publikë, por në kuptim të kësaj, procedura e njëjtë është e pazbatueshme ndaj të emëruarve politikë, meqë ligji në fjalë i përjashton të emëruarit politikë nga zbatueshmëria e tij.

Në bazë të nenit 2 të këtij Draft-Kodi, ku parashihet fushëveprimi i Kodit, aty theksohet se dispozitat e Kodit zbatohen për të gjithë zyrtarët e Kryeqytetit gjatë ushtrimit të funksioneve, detyrave ose kompetencave publike.

Megjithatë, në nenin 32 “Masat Disiplinore” parashihet që Kodi duhet të zbatohet nga zyrtarët publikë. *“Zyrtari publik që shkel dispozitat e përcaktuara në këtë Kod dhe veprimet e tij/saj nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

Se çka nënkupton shprehja zyrtar publik sipas Kodit të Etikës, saktësisht në nenin 3 tek pjesa “Përkufizimet” thuhet *“Zyrtari publik - përfshin zyrtarët siç përcaktohet në paragrafin 2 i nenit 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë”.*

Neni 2 i Ligjit 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, paragrafi i dytë përfshinë edhe nëpunës të kabinetit dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës.

*“2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil);
2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik;
2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe
2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.”*

Kjo çështje nuk ka arritur të adresojë në tërësi kërkesat dhe standardet europiane të qeverisjes së mirë lokale.⁷

Megjithatë, Rregullorja për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë 11/2020 dhe Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civilë 01/2024 që ka shfuqizuar rregulloren paraprake, e që derivon nga Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197, përjashton të zgjedhurit, të emëruarit politikë dhe zyrtarët e kabinetit.

⁷ Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal e qasshme në linkun - [1680746f16 \(coe.int\)](https://www.coe.int)

Kjo nënkupton se edhe pse Draft-Kodi i Kryeqytetit ka paraparë edhe zyrtarët politikë komunalë t'i nënshtrohen përcaktimeve të këtij Kodi, nuk është përcaktuar ndonjë procedurë specifike e rregulluar dhe efikase disiplinore për ta.

Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal⁸ e Këshillit të Europës ka paraparë parimet e qeverisjes së mirë në nivel lokal. Parimi i gjashtë i kësaj Strategjie parasheh sjelljen etike që pritet edhe nga zyrtarët e zgjedhur dhe politikë.

Draft-Kodi i Etikës së Kryeqytetit nuk ka arritur të përcaktojë procedura të qarta për zyrtarët politikë.

Mungesa e aktiviteteve njoftuese për qytetarët rreth përgjegjësisë disiplinore të zyrtarëve

Kryeqyteti nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet njoftues/informues për të njoftuar qytetarët më shumë sesa ajo e kutisë së ankesave lidhur me të drejtën e tyre për të iniciuar kërkesë për inicim të procedurës ndaj zyrtarëve, procedurat që duhet ndjekur, afatet e parashkrimit të shkeljeve dhe çështjet tjera që ndërlidhen me procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve komunalë ashtu siç parashihet me Rregulloren nr. 01/2024 për disiplinën e nëpunësve civilë⁹.

“Nëpër secilin vend në të cilin ofrohet shërbim, i kanë kutitë e ankesave ku qytetarët mundën me i shfaqë pakënaqësitë. Nuk kemi bërë diçka më shumë së ajo¹⁰”, ka njoftuar z.Aliu.

Viti	Numri i ankesave të paraqitura nga qytetarët ndaj zyrtarëve të Kryeqytetit
2022	0
2023	0

Të dhënat e paraqitura në tabelë më lartë pasqyrojnë sesi qytetarët në Kryeqytet nuk kanë paraqitur asnjë rast të vetëm në dy vitet e fundit për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarëve komunalë.

Aktiviteteve njoftuese / trajnimi i zyrtarëve lidhur me procedurat disiplinore

Njësia e Burimeve Njerëzore ka konfirmuar se me publikimin e Rregullores për Disiplinën i ka njoftuar udhëheqësit e drejtorive për publikimin e rregullores në fjalë, kurse ka organizuar edhe trajnime me IKAP-in për zyrtarët komunalë.

Tutje, U.D i NjMBNj-së ka njoftuar se momentalisht nuk kanë mundësi të organizojnë trajnime por se kanë planifikuar të organizojë trajnime në të ardhmen.

⁸ Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal e qasshme në linkun - [1680746f16 \(coe.int\)](https://www.coe.int)

⁹ Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civilë, 01/24, neni 6 pika 4, 1.2 e qasshme në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85634>

¹⁰ Intervistë e realizuar nga BIRN me z.Fadil Aliu, .D Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Kryeqytet, më datë 18.03.2024

“Trajnimet fatkeqësisht nuk po kemi mundësi me i organizu, por IKAP-i ka ofruar, por nuk ka feedback të mirë nga zyrtarët. Zyrtarja përgjegjëse për të gjitha trajnimet është kontakt person me IKAP, ua dërgon punonjësve listën e trajnimeve dhe kush shfaq dëshirë i shkruan zyrtares. Kam në plan që sallën e rekrutimeve ta shfrytëzojmë për trajnime, dhe përmes thirrjes publike për institute që ofrojnë trajnime për shërbime për nevojat e komunës” – tha z.Aliu.

Draft-Kodi i Kryeqytetit ka paraparë detyrimin për zyrtarët komunalë që të raportojnë kur janë në dijeni se është bërë shkelje e ndonjë dispozitë të këtij Kodi.

“Çdo zyrtar i Kryeqytetit që është në dijeni, dyshon për një shkelje të dispozitave të këtij Kodi, duhet të raportojë shkeljen te komisioni apo mbikëqyrësi i drejtpërdrejt.” – thuhet në nenin 32 të Draft-Kodit tek “Masat Disiplinore”.

Viti	Numri i ankesave të paraqitura nga zyrtarët ndaj zyrtarëve të Komunës
2022	0
2023	0

Të dhënat e paraqitura në tabelë më lartë pasqyrojnë sesi zyrtarët në Kryeqytet nuk kanë paraqitur asnjë rast të vetëm në dy vitet e fundit për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarëve komunalë.

Numri i ankesave të paraqitura në Komisionet Disiplinore gjatë viteve 2022-2023

Viti	Numri i Procedurave disiplinore të zhvilluara për nëpunës të shërbimit civil	Numri i ankesave të hedhura poshtë	Iniciuesi i kërkesës
2022	4	1	Mbikëqyrësi Direkt
2023			

Mënyra e zgjidhjes së rasteve

Mënyra e zgjidhjes së rasteve disiplinore	Nëpunës të shërbimit civil
2022	3 raste - Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës
2023	

Kjo tabelë pasqyron të dhënat lidhur me llojin e masës së shqiptuar nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Kryeqytet përgjatë viteve 2022-2023.

Në tri rastet nga Komisioni Disiplinor është shqiptuar masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Ankesat e hedhura poshtë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Viti	Numri i Ankesave të hedhura poshtë
2022	1
2023	

Sipas të dhënave të marra nga Kryeqyteti rezulton se një nëpunës civil është drejtuar me ankesë ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor përgjatë dy viteve të fundit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Të dhënat nga pyetësorët

Me qëllim të pasqyrit të njohjes së disa prej koncepteve bazike lidhur me legjislacionin publik për procedurën disiplinore dhe Rregullores për Disiplinë për Nëpunësit Civil, BIRN ka hartuar pyetësorin për zyrtarët e Kryeqytetit, të cilët janë përzgjedhur në mënyrë rastësore. Të dhënat që mund të identifikojnë pjesëmarrësit në pyetësor nuk janë kërkuar.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të zyrtarëve pjesëmarrës në pyetësor

6 zyrtarë	0 deri 1 vjet
1 zyrtar	5 deri 10 vjet
3 zyrtarë	Më shumë se 10 vjet

Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve lidhur me Kodin e Etikës

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Sa është shuma e dhuratave që mund të pranojnë zyrtarët në punën e tyre?	6	1	3
2. Kujt duhet t'i raportoni për pranimin e dhuratave	9	0	1
3. Sa anëtarë ka komisioni disiplinor?	8	0	2
4. A lejohet pjesëmarrja në vendimmarrje për të disiplinuar, ngritur në detyrë, disiplinuar apo shkarkuar personin e afërm	7	0	3

Nga të dhënat e pyetësorëve, rezulton se zyrtarët e Kryeqytetit kanë njohuri bazike lidhur me konceptin e nepotizimit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, raportimin mbi pranimin e dhuratave dhe përbërjen e komisionit. Nga 10 zyrtarë të intervistuar, vetëm 6 nga ta kanë pasur njohuri të saktë lidhur me shumën që mund të pranojnë si dhuratë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Trajnimet e zyrtarëve komunalë lidhur me Rregulloren për Disiplinë

2 trajnime	1 zyrtar
1 trajnim	2 zyrtarë
Asnjë deri më tani	6 zyrtarë

Nga 10 zyrtarë të intervistuar me pyetësor, 6 nga ta kanë deklaruar se nuk u është mbajtur asnjë trajnim atyre lidhur me Rregulloren për Disiplinë, kurse 2 zyrtarë kanë deklaruar se u është mbajtur një trajnim atyre, një zyrtar ka deklaruar se janë mbajtur 2 trajnime atij, kurse një zyrtar nuk e ka plotësuar rubrikën.

Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve komunalë lidhur me Rregullat dhe procedurën disiplinore

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Kush është kompetent për shqiptimin e masave disiplinore?	4	4	2
2. Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore merren parasysh edhe përpjekjet për zvogëlimin e dëmit?	8	0	2
3. Sa është afati për ankesë ndaj vendimit disiplinor?	8	0	2
4. Shkelja e përsëritur e rregullave të Kodit të Etikës konsiderohet si shkelje e lehtë?	7	0	3
5. Kush e shqipton masën “ndalimi i ngritjes në detyrë”?	7	0	3
6. Afati i parashkrimit të shkeljeve të lehta është 3 vjet kurse i shkeljeve të rënda 6 vjet?	5	0	5
7. Kush e bënë kualifikimin e shkeljeve në të rënda apo të lehta?	1	0	9
8. Kush e themelon Komisionin Disiplinor?	7	0	3
9. Kush është shkalla e dytë ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor?	8	1	2

Prej pjesës së pyetjeve nga Rregullorja për Disiplinë rezulton se për shumicën dërrmuese të pyetjeve, zyrtarët kanë pasur njohuri bazike.

Nga 10 zyrtarë të intervistuar 9 zyrtarë nuk kanë pasur njohuri se kush është autoriteti i cili e bën kualifikimin e shkeljeve të lehta dhe të rënda në procedurë disiplinore, kurse vetëm 4 nga ta e kanë ditur se kush është kompetent për shqiptimin e masave disiplinore.

50% e zyrtarëve nuk kanë pasur njohuri se cili është afati i parashkrimit të shkeljeve të lehta dhe të rënda. Por, zyrtarët kanë shfaqur njohuri lidhur me fushën e ankimimit ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor.

Mungesa e trajnimeve për anëtarët e Komisionit disiplinor dhe mungesa e kompensimit shtesë për anëtarët e saj

Anëtarët e Komisionit Disiplinor të Kryeqytetit nuk i janë nënshtruar asnjë trajnimi lidhur me procedurat disiplinore të përcaktuara me rregulloret dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë, para se të përzgjidheshin ose pasi janë përzgjedhur.

Po ashtu, zyrtarët që shërbejnë si anëtarë të komisioneve disiplinore nuk kompensohen për punën e tyre si anëtarë të komisionit.

Rekomandimet:

- Kryeqyteti të plotësojë Draft-Kodin e Etikës dhe të përcaktojë procedura të qarta për trajtimin e rasteve disiplinore ndaj të zgjedhurve dhe të emëruarve politikë dhe stafit të tyre mbështetës;
- Kryeqyteti të ndryshojë Draft-Kodin e Etikës, saktësisht të fshijë paragrafin 2 të nenit 5 të Draft-Kodit të Etikës me të cilën dispozitë synohet të detyrohen zyrtarët politikë të mos ndërrojnë partinë e tyre;
- Kryeqyteti të ndërtojë fushata vetëdijësuese me qëllim të njoftimit të qytetarëve lidhur me procedurat disiplinore të cilave mund t’iu nënshtrohen zyrtarët komunalë me qëllim të rritjes së numrit të ankesave të qytetarëve;
- Kryeqyteti të zhvillojë trajnime me zyrtarët komunalë me qëllim të përditësimit të njohurive lidhur me vendimmarrjen në situata të konfliktit të interesit dhe konfliktit të interesit në përgjithësi;
- Kryeqyteti të fillojë programe për trajnimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore;
- Kryeqyteti të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve komunalë në drejtim të instrumenteve për parandalimin e korrupsionit;
- Kryeqyteti të ndërtojë modalitete për mbikëqyrjen e cilësisë së punës – në veçanti politikën ndëshkimore disiplinore të komisioneve disiplinore.

Kjo analizë është përgatitur nga BIRN-i përmes mbështetjes nga Aktiviteti i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për Integritetin e Komunave të Kosovës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë artikull nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.